

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq


Në mbështetje të nenit 12.2, pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës nga DMM-ja, nr., të IX-155, të dt.18.10.2022, në mbledhjen e mbajtur me dt.26.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.
2. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

- T'idërgohet
- Kryetarit
 - Nënkryetarit
 - Kryesueses
 - Anëtarëve të KK
 - MAPL
 - DAP
 - DMM
 - Arkivit





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



**RREGULLORE (KO) Nr.07/2022 PËR MENAXHIMIN E
MBETURINAVE NË KOMUNËN E OBILIQIT**

KUVENDI I KOMUNAL OBILIQ

Në pajtim me nenin 12, paragrafi, 12.2 pika c dhe nenin 17 pika f, të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), nenet 15 dhe 34 (2) të Ligjit nr. 04/L – 60, për Mbeturina, në nenin 8 pika a, nenin 15 pika f, dhe nenin 19 paragrafi 1, të Ligjit nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, në nenin 37 paragrafi 1.6, nenin 38 paragrafi 1.3, nenin 44 paragrafi 2.1 të Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 datë 25.04.2016, Kuvendi i Komunës së Obiliqit, në mbledhjen e mbajtur më 26.10.2022, miraton këtë:

RREGULLORE (KO) Nr.07/2022 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E OBILIQIT

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

Kjo rregullore përshkruan përmbajtjen e vendimit për mënyrën e ofrimit të shërbimit publik, mënyrën e menaxhimit të mbeturinave në lidhje me shërbimin publik të mbledhjes së mbeturinave të përziara, mbeturinave të biodegradueshme komunale dhe mbledhjen e veçantë të mbeturinave të letrës, metalit, qelqit, plastikës, tekstilit, mbeturinat problematike dhe mbeturinat e vëllimshme, shpërndarja hapësinore e pikave të riciklimit, metoda e llogaritjes së sasisë së mbeturinave të përziara komunale për periudha të caktuara kohore, mënyra dhe kushtet e përcaktimit dhe llogaritjes së tarifës për pagesën e mbeturinave komunale për amvisëri dhe biznese.

Neni 2

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të rregulloj sistemin e menaxhimit të mbeturinave komunale, tarifën për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave dhe krijimin e një sistemi të qëndrueshëm financiar në Komunën e Obiliqit.

Neni 3

Fushëveprimi

Kjo Rregullore definon kushtet për menaxhimin e integruar të mbeturinave (zvogëlimin e sasisë së deponuar, ndarjen, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, deponimin dhe aktivitetet e riciklimit) me qëllim të ruajtjes së mjedisit.

Neni 4

Përkufizimet

1. **Mbeturina** - substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar ta hedh.
2. **Menaxhim i mbeturinave** – aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin

- përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.
3. **Gjeneruesi i mbeturinave** - subjekt fizik apo juridik i cilësuar si krijuesi i mbeturinave.
 4. **Operator** - personi, i cili në përputhje me dispozitat e ligjit për menaxhim të mbeturinave nr. 04/L – 60 kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve.
 5. **Ministria** – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.
 6. **DMM** – Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit – Komuna e Obiliqit.
 7. **Licenca për menaxhimin e mbeturinave** - leje me shkrim e cila lëshohet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas Ligjeve në fuqi.
 8. **Person** - person fizik ose juridik i cili është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhim të mbeturinave.
 9. **Konsumatori** – person i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara.
 10. **Ri-përdorimi** - çfarëdo operimi me të cilin çdo produkt apo komponent e cila nuk është mbeturinë dhe përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin është destinuar.
 11. **Mbledhja** – mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri të objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave.
 12. **Mbledhja e ndarë** - nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik.
 13. **Prodhuesi i mbeturinës** - çdo person, veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.
 14. **Zotëruesi i mbeturinës** - prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën.
 15. **Mbeturina komunale** - mbeturina nga amvisëritë, dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.
 16. **Mbeturina e parrezikshme** - mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.
 17. **Mbeturina komerciale** - mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale.
 18. **Mbeturina inerte** - mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:
 - a) Mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.
 - b) I tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
 19. **Mbeturinë e vëllimshme** – mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të

- veçantë.
20. **Qendër grumbulluese** – lokacioni për pranimin përkatësisht grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të përcaktuara nga qendra.
 21. **Pikë grumbulluese** – lokacioni ku janë të vendosur shportat, kontejnerët dhe qeset/thasët për grumbullimin e mbeturinave komunale.
 22. **3R** – reduktim, ripërdorim, reciklim.

Neni 5 Përjashtimet

1. Nga kjo Rregullore përjashtohen mbeturinat në vijim:
 - a. Mbeturinat e rrezikshme,
 - b. Mbeturina medicinale, dhe
 - c. Llumi/ balta dhe mbeturina të ngjashme.
2. Menaxhimi i tyre rregullohet në bazë të udhëzimeve të veçanta administrative përkatëse të ministrisë.

Neni 6 Përgjegjësitë e Komunës mbi Menaxhimin e Mbeturinave

1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.
2. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.
3. Procesi i kontraktimit për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave.
4. Themelimi i sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave, në kuadër të DMM-së që të planifikojë, rregullojë, udhëheqë dhe zbatoj planin komunal të menaxhimit të mbeturinave, si dhe të udhëzojë, monitoroj ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave.
5. Menaxhimi i mbeturinave komunale nga ndërtim – demolimi, si dhe i mbeturinave inerte, komerciale, dhe të vëllimshme.
6. Përcaktimi i lokacionit për qendrën grumbulluese për mbeturinat e vëllimshme, dhe mbeturinat elektrike dhe elektronike.
7. Pas sigurimit të lokacionit për hedhjen e mbeturinave inerte, do të bëhet vendosja e kontejnerëve për mbeturina inerte në të gjitha vendbanimet.
8. Përcaktimi i lokacioneve për vendosjen e shportave dhe kontejnerëve komunal.
9. Përcaktimi i llojit të kontejnerëve të përshtatshëm me teknikën me të cilën bëhet mbledhja, ndarja dhe transportimi i tyre.
10. Përcaktimi dhe publikimi i orarit dhe dinamikës së mbledhjes së mbeturinave në marrëveshje me operatorin.
11. Sipas nevojës, autorizon operatorin që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë.
12. Identifikimi i pikave ilegale të mbeturinave dhe eliminimi i tyre.
13. Sektori për menaxhim të mbeturinave shqyrton ankesat e klientëve sa i përket shërbimit të grumbullimit të mbeturinave përmes komisionit përkatës.
14. Sigurimi i kushteve të veprimt dhe operimit për operatorin.
15. Përcaktimi i tarifave dhe mënyra e inkasimit.

16. Promovimi i konceptit për minimizim të mbeturinave - 3R.
17. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave komunale.
18. Përpilimi i raporteve mbi menaxhimin e mbeturinave.
19. Hartimi dhe dorëzimi i raportit vjetor në Ministri bazuar në ligjet në fuqi.
20. Grumbullimi, transporti dhe deponimi i mbeturinave të vëllimshme, gjashtë (6) herë në vit, çdo dy muaj, pa pagesë.

Neni 7

Përgjegjësitë e Operatorit

Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues për ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave është i obliguar që të veproj sipas marrëveshjes së nënshkruar dhe ligjeve në fuqi.

Neni 8

Të Drejtat dhe Detyrat e Gjeneruesve të Mbeturinave

1. Çdo gjenerues i mbeturinave obligohet të kyçet në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave;
2. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen:
 - a) Amvisëritë të cilave ju shërbehet derë me derë , mbeturinat duhet ti ndajnë dhe ti vendosin sipas sistemit të përcaktuar nga Komuna;
 - b) Në banimet kolektive ku shërbimi bëhet në pika grumbulluese me kontejner, mbeturinat duhet ti ndajnë dhe ti vendosin sipas sistemit të përcaktuar nga Komuna.
3. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë ankese ndaj shërbimit të ofruar;
4. Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave përmes kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme;
5. Çdo gjenerues duhet të paraqesë ndryshimin e të dhënave (p.sh. shitja e pronës, trashëgimia, dëshmitë dhe dokumentet tjera të përditësuar);
6. Gjeneruesit e mbeturinave duhet të regjistrohen në regjistrin e shërbimeve të konsumatorëve për mbeturina, regjistrimet e reja të amvisërive (gjeneruesve) në sistemin e të dhënave të bëhen në bazë të kushteve si më poshtë:
 - a. Kontrata e shitblerjes;
 - b. Blerësi regjistrohet në sistem të të dhënave, nëse nuk është i regjistruar paraprakisht nga data e nënshkrimit të kontratës, derisa shitësit i ndryshohet vetëm adresa;
 - c. Regjistrimi i njehsorit të energjisë elektrike;
 - d. Konfirmimi i pagesës së faturës për mbeturina në vendbanimin paraprak;
 - e. Dokumenti identifikues.
7. Çdo gjenerues duhet të bashkëpunojë me autoritetin publik, për të siguruar një mjedis të pastër;
8. Ndërmarrjet prodhuese të cilat gjenerojnë mbeturina, obligohen që komunës t'ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave të cilat i gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë;
9. Çdo gjenerues obligohet që ti largojë mbeturinat që krijohen gjatë procesit të ndërtimit,

- meremetimit apo demolimit të objekteve, nga hapësirat ose vendet publike;
10. Shërbimet e veçanta, (largimi i mbeturinave të vëllimshme, dhe mbeturinave të tjera që nuk largohen gjatë shërbimit të rregullt), bëhen me pagesë, përveç shërbimeve sipas nenit 4 pika 4.19;
11. Bizneset të cilat ushtrojnë veprimtari të ndryshme janë të obliguar që ta mbajnë të pastër hapësirën para objektit dhe përreth tyre.

Neni 9

Kategorizimi i Gjeneruesve të Mbeturinave

1. Gjeneruesit e mbeturinave ndahen në kategoritë si më poshtë:
- a. Kategoria e konsumatorëve shtëpiak - amvisëritë:**
- i. **Nënkategoria e parë:** konsumatorët e shërbyer derë me derë - zona urbane dhe zona rurale.
 - ii. **Nënkategoria e dytë:** konsumatorët e shërbyer me kontejnerë të përbashkët – zona urbane dhe zona rurale.
- b. Kategoria e konsumatorëve Komercial/Industrial:**
- i. **Nënkategoria e parë:** veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese. Në këtë kategori bëjnë pjesë këto veprimtari të bizneseve: kioska, kafe pjekëse shitore, shitës të CD-ve dhe kasetave, argjendari, orëtar, agjencione turistike, avokatura, video lojërat, video klub, internet kafe, rrobaqepës, këpucëtarë, dyqan fotografish, pastrim kimik, kozmetika, optika, gurë gdhendës, saraç-mbathtarë, zyra e inkasimit, OJQ, shitore suvenirësh, këmbimore, auto parking, butik, librari, llamarine punues, axhustator, kurse të gjuhëve dhe IT- së.
 - ii. **Nënkategoria e dytë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të ulët të shërbimit. Në këtë nënkategori bëjnë pjesë këto veprimtari të bizneseve: auto larje, frizer meshkujsh dhe femrash, ëmbëltore, shitore tekstili, shitore të auto-pjesëve, hekurishte, shitore sanitare, sallon i vogël i mobileve, shitore këpucësh, servise të ndryshme (elektroteknike dhe TI), shitore të ndryshme, objekte fetare të vogla, zyra të partive politike, farmaci, zyrat postare e të ngjashme, bastore, klinike (ordinance private), ordinance stomatologjike deri ne dy karrige, automekanik, auto elektrikist, auto saldues, auto sallon, dhe byrektore.
 - iii. **Nënkategoria e tretë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të moderuar të shërbimit. Në këtë nënkategori bëjnë pjesë këto veprimtari të bizneseve: furra të bukës dhe byrektore, kafeteri, minimarket - shitore ushqimore, podrume të pijeve, poliklinike, filiale të bankave, sallone të sanitarisë, sallon i madh mobiliesh, qendrat sportive e të ngjashme), qendra te fitnesit, auto ngjyrosësh, fastfood, bujtina, pompa te benzinës, xhamprerëse, dhe ordinance stomatologjike mbi dy karrige.
 - iv. **Nënkategoria e katërt:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të lartë të shërbimit. Në këtë nënkategori bëjnë pjesë këto veprimtari të bizneseve: gjellëtoore, restorant-qebaptore, restorante, fastfood, diskoteka, hotele, motele, dhe pompa te benzinës me restorant.

- v. **Nënkategoria e pestë:** subjektet komercial/industrial të shërbyer me kontrata të veçanta, konkretisht me kontejnerë 1.1m³ dhe 7m³. Në këtë nënkategori bëjnë pjesë të gjithë subjektet komercial/industrial të cilët kanë hapësirë që brenda pronës së tyre të vendosin kontejnerë 1.1 m³ dhe 7m³.
- c. **Kategoria e konsumatorëve institucional.** Konsumatorët në këtë kategori do të shërbehen më kontrata të veçanta me kontejnerë 1.1 m³ dhe 7 m³.
Kategoria e konsumatorëve institucional ndahet në:
(1) nënkategorinë e konsumatorëve të institucioneve komunale; dhe (2) të konsumatorëve të institucioneve të nivelit qendror. Në nënkategorinë e konsumatorëve të institucioneve komunale bëjnë pjesë: shkollat fillore dhe të mesme, institucionet parashkollore, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, bashkësitë lokale, zyret e vendit, objektet e komunës, teatri, kinemaja, objektet kulturore, objektet sportive, zjarrfikësit dhe bashkësitë fetare. Në nënkategorinë e konsumatorëve të institucioneve qendrore dhe organizatave ndërkombëtare bëjnë pjesë: institucione shëndetësore publike dhe private, Policia e Kosovës, ndërmarrjet publike, posta, gjykata, agjencionet e pavarura, dhe qendra për punë sociale.

Neni 10

Tarifa për Grumbullim, Transportim, dhe Deponim të Mbeturinave

1. Kategoritë e konsumatorëve do të paguajnë faturë mujore për shërbimin e grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave si në vijim:
 - 1.1 **Kategoria e konsumatorëve shtëpiak** – amvisëritë do të paguajnë tarifë fikse prej **4.65 €** (euro) në muaj.
 - 1.1.1 Banorët jo-rezident (diaspora) obligohen ti kryejnë detyrimet financiare ndaj kompanisë **15 €** (euro) për një vit kalendarik.
 - 1.2 **Kategoria e konsumatorëve Komercial/Industrial.**
 - 1.2.1 **Nënkategoria e parë:** veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese do të paguajnë tarifë fikse prej **5.30 €** (euro) në muaj.
 - 1.2.2 **Nënkategoria e dytë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të ulët të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej **9.20 €** (euro) në muaj.
 - 1.2.3 **Nënkategoria e tretë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të moderuar të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej **12.8 €** (euro) në muaj.
 - 1.2.4 **Nënkategoria e katërt:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të lartë të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej **24.0 €** (euro) në muaj.
 - 1.2.5 **Nënkategoria e pestë:** subjektet komerciale/industriale të shërbyer me kontrata të veçanta, konkretisht me kontejnerë **1.1m³** dhe **7m³**, do të paguajnë tarifë prej **12.0 €** (euro) për një zbrazje për kontejnerë **1.1m³**, dhe **36.8 €** (euro) për një zbrazje për kontejnerë **7m³**.
 - 1.3 **Kategoria e konsumatorëve institucional** do të paguajnë tarifë fikse prej **12.0€** (euro) për një zbrazje për kontejnerë **1.1m³**, dhe **36.8 €** (euro) për një zbrazje për kontejnerë **7m³**.

2. Shkalla e tarifës mund të rishikohet çdo dy vite nga Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 11 **Veprimet e Ndaluar**

Me këtë rregullore ndalohen veprimet si më poshtë:

1. Hedhja e mbeturinave në hapësira tjera përveç se në vendin e destinuar për deponim;
2. Hedhja e mbeturinave nga ndërtim – demolimi në rrugë, trotuare, hapësira publike, prona private, shporta, dhe kontejnerë të destinuar për mbeturina komunale;
3. Hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve kolektive;
4. Përzjerja dhe hudhja e mbeturinave brenda dhe jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme;
5. Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;
6. Hedhja dhe deponimi i mbeturinave komunale në hapësira publike (në rrugë, parqe, dhe në vende të tjera publike) dhe në prona private;
7. Hedhja e çfarëdo lloji të mbeturinave në brigje dhe në lumenjë, liqenjë, rrjedha ujore, përrocka dhe sipërfaqe tjera me ujë;
8. Ndërrimi i lokacionit të kontejnerëve dhe pikave për hedhjen e mbeturinave pa autorizim të autoriteteve komunale;
9. Djegia e mbeturinave në hapësira publike (në rrugë, parqe, dhe natyrë), në prona private, shporta, kontejnerë dhe në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave;
10. Nxjerrja dhe shpërndarja e mbeturinave nga kontejnerët ose nga pikat mbledhëse të mbeturinave;
11. Shfrytëzimi i mbeturinave nga kontejnerët ose nga pikat mbledhëse të mbeturinave si ushqim për kafshët apo të ngjashme;
12. Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin “*mbeturina komunale dhe komerciale*”;
13. Hedhja e mbeturinave jashtë shportave, kontejnerëve dhe pikave grumbulluese për mbeturina komunale;
14. Derdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë grumbullimit dhe transportimit të tyre;
15. Personat fizik dhe juridik duhet të marrin masa që gjatë transportimit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave;
16. Ndryshimi i mënyrës, metodave, teknikës dhe teknologjisë së largimit të mbeturinave në kundërshtim me kushtet e përcaktuar me kontratë apo ndonjë formë tjetër;
17. Mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme nuk guxojnë të hedhen në kontejnerë publik të mbeturinave ose në afërsi të tyre.

Neni 12 **Dispozitat Ndëshkuese – Gjobat**

1. Çdo person fizik apo juridik i cili shkel dispozitat e neneve të kësaj Rregulloreje do të

shkaktoj kundërvajtje dhe do të ndëshkohet sipas neneve 71, 72, dhe 73 të Ligjit për Mbeturina 04/L-060, Ligji nr.03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit, Udhëzimeve Administrative për ndëshkimet dhe gjobat mandatore.

2. Për shkelësit e dispozitave të kësaj Rregulloreje, për veprimet e ndaluara sipas nenit 11, (nën par. 1-17) inspektori i mjedisit, inspektori komunal, zyrtari policor, shqiptojnë gjobat si më poshtë:
 - 2.1 Çdo person fizik apo juridik i cili vepron në kundërshtim me paragrafët 5 dhe 8, të nenit 11 të kësaj rregulloreje gjobitet me shumën prej tridhjetë euro (30€).
 - 2.2 Çdo person fizik apo juridik i cili vepron në kundërshtim me paragrafët 6, 13, dhe 15 të nenit 11 të kësaj rregulloreje gjobitet me shumën prej pesëdhjetë euro (50€).
 - 2.3 Çdo person fizik apo juridik i cili vepron në kundërshtim me paragrafët 1, 2, 3, 4, 11 dhe 16 të nenit 11 të kësaj rregulloreje gjobitet me shumën prej shtatëdhjetë euro (70€).
 - 2.4 Çdo person fizik apo juridik i cili vepron në kundërshtim me paragrafët 7, dhe 14 të nenit 11 të kësaj rregulloreje gjobitet me shumën prej njëqind euro (100€).
3. Ndaj gjeneruesit të mbeturinave i cili nuk e bën pagesën e taksës për mbeturina dhe i cili nuk i përmbahet rregullores, do të iniciohet procedurë ligjore përmbarese sipas ligjeve në fuqi, në gjykatën kompetente.
4. Të gjithë gjeneruesit e mbeturinave që kanë faturat të pa paguara për gjashtë (6) muajt e fundit, do të iniciohet procedurë përmbarese.
5. Shumat e gjobave të cilat i shqipton inspektori i mjedisit janë të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore të ministrit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe me këtë rregullore.
 - a) kundër vendimit të inspektorit të mjedisit mund të parashtrahet ankesa në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 13

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

1. Në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi.
2. Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje është: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Inspektion, dhe njësitë përkatëse të administratës komunale.
3. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bën Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, Drejtoria e Inspektionit dhe zyrtaret tjerë të autorizuar nga ana e Komunës.
4. Për këtë rregullore njoftohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Ministria

e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Neni 14
Hyrja në Fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha dispozitat e Rregullores mbi administrimin e mbeturinave, pastrimin e rrugëve, shesheve dhe trotuareve në territorin e komunës me nr.I-127 datë 29.09.2014.
2. Kjo rregullore hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Kuvendi i Komunal Obiliq

Data: 26.10.2022

Vlora Mjekiqi - Kabashi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës

